



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nënparagrafi i) i Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nënparagrafi 8 dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet dhe plotësimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Propozimet e takimit me shefat e subjekteve politike dhe përfaqësuesit e tyre, Ekzekutivit-Kryetarit dhe propozimet e dala nga Komisioni për Standardizimin e emërtimeve të Lagjeve, shesheve dhe rrugëve të Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të radhës për vitin 2013, të mbajtur më 26.07.2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Për

### Standardizimin e Emërtimeve të Lagjeve, Shesheve dhe Rrugëve të Klinës

#### I

**Miratohen**, Propozimet për Standardizimin e Emërtimeve të Lagjeve, Shesheve dhe Rrugëve të Klinës.

#### II

Propozimet, si në pikën 1 të këtij vendimi miratohen, duke plotësuar Regjistrin e Komisionit Komunal për standardizimin e emërtimeve që është pjesë përbërëse e këtij vendimi me propozimet e dala nga Kuvendi i Komunës për rrugët e paemëtuara që të emërtohen si në vijim:

1. Rrugës - "Llesh Gjonllëshi" t'i bashkëngjitet edhe emri "Pjeter Jaku"
2. Emrit të dëshmorit "Ilir Merturi" t'i gjendët vendi i merituar
3. Emri i "Prekë Zef Ademi" gjithashtu t'i gjendët vendi i merituar dhe
4. Salla e Sportit të emërtohet me emrin "Adem Jashari"
5. "Masakra e Baranit",
6. "Toni Bler"
7. "Beteja e Qelisë"
8. "Deshmorët e Sferkës"
9. "Rruga e UÇK"

#### III

Mundësit për plotësime më emra të figurave të shquera mbesin çdoherë të mundshme me zhvillimin e Klinës dhe rrugët e sajë të reja të paemëtuara.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit.

V

Më këtë vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtorit Komunale, Zyra e Informimit, Një për Tabelë të Shpalljeve, Sherbimi i Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. *06.3482* /13  
Klinë më, *12.08.* 2013



KRYESUESI,  
Dr. Haxhi Ibishi

## KOMUNA E KLINËS

### PËR ASAMBLËN KOMUNALE TË KLINËS

#### NGA KOMISIONI KOMUNAL PËR STANDARDIZIMIN E EMERTIMEVE TË LAGJEVE, SHESHEVE DHE RRUGËVE TË KLINËS

Plotësimet dhe ndryshimet e komisionit pas autorizimit të Asamblesë dhe propozimeve të dhëna në Asamblesë e datës 26.07.2013 me propozimet dhe ndryshimet e reja të cilat komisioni i plotësoj me ndryshimin e emërtimeve të rrugëve të mëparshme ose i vendosi në rrugë të reja. Me këto propozime dhe ndryshime hyn në fuqi vendimi i asamblesë komunale i seancës së VII-të radhës për vitin 2013, nr. 06.3482 i datës 12.08.2013.

#### REGJISTRI I STANDARDIZIMIT DHE RIEMËRTIMIT LAGJEVE, SHESHEVE DHE RRUGËVE TË KLINËS

1. Pjesa e Klinës në të djathtë në hyrje në qytet emërohet lagjja *Iliria*.
2. Pjesa e Klinës në të majtë të hyrjes në qytet nga Peja emërohet lagjja *Dardania*.
3. Lagjja përtej hekurudhës Klinë – Prizren emërohet lagjja *Dukagjini*.
4. Lagjja e përllinave emërohet lagjja *Arbëria*.
5. Lagjja në të djathtë të hekurudhës Fushë Kosove- Klinë-Peje, emërohet lagjja *Drenica*.

#### 1. Kemi 5 lagje

1. Sheshi i mëparshëm Vëllazërim Bashkim emërohet sheshi *Mujë Krasniqi*.
2. Pas punës së komisionit- emërtohet edhe sheshi *Nëna Terezë*.
3. Sheshi *Faruk Elezi*.
4. Sheshi tjetër *Ndue Përlleshi*.
5. Sheshi *Martirët e Kombit* të lapidari i martirëve.

#### 2. Kemi 5 sheshe

1. Rruga e mëparshme M.Tito, prej udhëkryqit të rrugës magjistrale Prishtinë – Pejë deri te sheshi Ndue Përlleshi emërtohet rruga (**Sadik Rama**), (marrëveshje me grupet e asamblistëve)
2. Rruga prej sheshit Ndue Përlleshi deri te sheshi Mujë Krasniqi emërohet emërtohet rruga (**Abedin Rexha**).
3. Rruga nga sheshi Mujë Krasniqi deri te hekurudha për Pejë emërohet(**Dëshmorët e Kombit**).
4. \*Rruga përtej hekurudhe kah Ujmiri emërohet (**Lidhja e Prizrenit**).
5. Rruga e nga sheshi Mujë Krasniqi deri te hekurudha për Zllakuqan emërohet (**GJ. K. Skënderbeu**), (marrëveshje me grupet e asamblistëve)
6. Rruga e parë në të djathtë të Skënderbeut përtej Sheshit Nënë Tereza emërohet (**Dëshmorët e Sferrkës**)
7. Rruga prej hekurudhës për Zllakuqan emërohet (**Leonard Paluci**) ((marrëveshje me grupet e asamblistëve)
8. Rruga e mëparshme E. Kardeli e Gjimnazit emërtohet rruga prof. (**Ymër Berisha**).
9. Rruga e mëparshme A. Kelmendi nga rruga Y. Berisha deri te Sefer Manët mbetet (**Ali Kelmendi**), (marrëveshje me grupet e asamblistëve).
10. Rruga e mëparshme B. Curri nga Fontana deri te Nezir Berisha riemërohet rruga (**Bajram Curri**).
11. Rruga e mëparshme G. Tërbeshi nga rruga Y. Berisha kah Dushet deri te Dispanseri emetohet rruga e (**Dusheve**).
12. Rruga e mëparshme H. Prishtina nga kafja e pensionistëve deri te Sefër Manët riemërtohet rruga (**Hasan Prishtina**).
13. Rruga e mëparshme Drini i Bardhë prej sheshit Nënë Tereza deri te ai Faruk Elezi emërohet (**Mehmet Haxhaj**).



14. Rruga nga Sheshi Faruk Elezi deri te ura e hekurit mbi Dri emërohet (**Hoxhë Kadri Prishtina**), *(marrëveshje me grupet e asamblistëve)*
15. Rruga e mëparshme Mirusha prej rrugës Y. Berisha e deri te rruga M. Haxhaj emërtohet rruga (**Hamit Krasniqi**).
16. Rruga e mëparshme E. Duraku nga stacionit të veterinarisë deri te Mehedin Morina emërto. rruga(**Sënder Rexhepi**)
17. Rruga e mëparshme A. Frashri prej rrugës (Lidhja e Prizrenit) deri te rruga e Zallkuqit mbi shkollë fillore emërtohet rruga (**Mirushë Daka**), *emri i mëparshmen bartet në rrugë tjetër.*
18. Rruga e mëparshme A. Rustemi prej pemëtores së Malokëve e deri te rruga S. Rexhepi emërtohet rruga (**Arbenm Haliti**), *(marrëveshje me motrën e Arbenit-vendi i vrasjes dhe lapidarit).*
19. Rruga e mëparshme D. Tucoviq prej rrugës Dëshmorët e Kombit e deri te stadiumi futbollistik emërtohet rruga (**Mehdi Morina**).
20. Rruga e mëparshme Xh. Kada përtej hekurudhës së Prizrenit kah Malishgani emërtohet rruga (**Osman Krasniqi**)
21. Rruga e mëparshme 4 Korriku (TMK) në drejtim të fabrikës së këpucëve emërohet rruga (**Luan Haradinaj**), *marrëveshje me grupet parlamentare.*
22. Rruga e parë në të djathtë përtej TMK (Luan Haradinaj) deri te rruga I.Qemali emërtohet rruga (**Kongresi i Manastirit**) *H. Zeka bartet rruga deri te Urës së Haxhi Zekës.*
23. Rruga e dytë në të djathtë Të Luan Haradinajt e pa emërtuar te rezervari i hekurudhës emërohet (**Shaban Demaj**)
24. Rruga nga ura e Klinës e deri te Palucët emërtohet rruga (**Lekë Dukagjini**).
25. Rruga e mëparshme M. Bakia kah Z. Agushi deri pas ish TMK emërtohet rruga (**Ismal Qemali**).
26. Rruga e mëparshme M. Popoviq rruga e parë në të djathtë të rrugës Ismail Qemali emërtohet rruga (**Ramë Bllaca**).
27. Rruga e mëparshme A. Bajrami e dyta në të djathtë të I. Qemalit emërtohet rruga (**Isa Boletini**).
28. Rruga paralel me lumin Klina e deri te stadiumi futbollistik emërtohet rruga (**Fan Noli**).
29. Rruga e mëparshme Bistrica e treta në të djathtë të rrugës I. Qemali emërtohet rruga (**Agim Duraku**).
30. Rruga e katërt në të djathtë të rrugës I. Qemali emërtohet rruga (**Dedë Gjo Luli**)`.
31. Rruga që del nga rruga e ish-TMK e para në të djathtë të lumit Klina e deri te shtëpia e Sylë Deskut emërtohet rruga (**Kuvendi i Lezhës**).
32. Rruga e mëparshme S. Kovaqeviq nga vetëshërbimi i vjetër e deri te shtëpia e Hil Dulës emërtohet rruga (**Marie Shallaku**).
- 33.\*Rruga e parë në të djathtë të rrugës M. Haxhaj kah B. Preni emërohet (**Drini i Bardhë**), kërkesë e ekologëve.
34. Rruga që del në të majtë nga rruga M. Haxhaj e deri te stacioni i autobusit emërtohet rruga (**Kolë Mirdita**) (Ndue Perllëshi në Shesh). *(marrëveshje me grupet e asamblistëve dhe KPF)*
35. Rruga nga M. Daka në drejtim të shtëpisë së Rustem Sferrkës emërtohet rruga (**Bajram Rexhepi**). *Shaban Palluzha kalon në Përlina.*
36. Rruga e dytë në të djathtë të rrugës M.Daka emërtohet rruga (**Mic Sokoli**).
37. Rruga e tretë në të djathtë kah shtëpia e Jahir Kotorrit emërtohet rruga (**Zef Gjidoda**).
38. Rruga e IV në të djathtë të M. Dakës emërohet (**Ndrec Nikolla**) kërkesë për emërtim.
39. Rruga e mëparshme B. Millatoviq e para në të djathtë përtej hekurudhës kah Zllakuqani emërtohet rruga (**Sylejman Vokshi**).
40. Rruga e mëparshme Z. Hajdini e dyta në të djathtë të L. Palucajt emërtohet rruga (**Ferat Draga**) *(marrëveshje me grupet e asamblistëve)*
41. Rruga e mëparshme Zef L. Marku e treta në të djathtë emërtohet rruga (**Shotë dhe Azem Galica**).
42. Rruga e katërt në të djathtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Eqrem Çabej**).
43. Rruga e pestë në të djathtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Vëllezërit Frashri**).
44. Rruga e gjashtë në të djathtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Pashtrik Krasniqi**) *Gjergj Fishta në shkollën Jagodës)-(marrëveshje me grupet e asamblistëve e KPF).*

45. Rruga e shtatë në të djathtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Çeta e Kolë Gojanit**).
46. Rruga e tetë në të djathtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Imzot Mark Sopi**).
47. Rruga e nëntë në të djathtë të njëjtit drejtim kah Zllakuqani emërtohet rruga (**Feriz Boja**).
48. Rruga e dhjetë në të djathtë të rrugës kah Zllakuqani emërtohet rruga (**Murat Delia**).
49. Rruga e njëmbëdhjetë në të djathtë përtej rest."Kosova" emërtohet rruga (**Llesh Gjon LLeshi e Pjetër Jaku**)).
50. Rruga nga L. Palucaj për në Shtupel emërtohet (**Ukë Zeneli**)
51. Rruga e mëparshme R.Buxheviq rruga e parë kah Simonët emërtohet "**Vëllazrit Gervalla e Kadri Zeka**).
52. Rruga e dytë në të majtë në të njëjtin drejtim emërtohet rruga (**Jetulla Desku** )
53. Rruga e tretë në të majtë deri te kryqëzimi i Simonëve emërtohet rruga (**Dëshmorët e Resujës**).
54. Rruga e 4 në të majtë të Leonard Palucajt emërohet (**Martirët e Postaselit**)
55. Rruga e 5 ne të majtë të L.Palucajt emërohet (**Ramë Morina**)
56. Rruga e 6 në të majtë të L. Palucajt emërohet (**Mikel Marku**)
57. Rruga e mëparshme Tigveshi prej servisit të Racëve deri te shtëpia e Prekë Lleshit emërtohet (**Idriz Seferi**).
58. Rruga prej servisit të Racëve deri te rezervari i ujit emërtohet rruga ( **Zekë Brahimaj**).
- 59.Rruga e parë në të majtë të L. së Prizrenit emërohet (**Smajl Hajdari e Hali Sadria**).
60. Rruga e dytë në të majtë të L. së Prizrenit emërohet (**Sinan Morina**).
61. Rruga e tretë në të majtë të L. së Prizrenit emërohet (**Toni Bler**).
62. Rruga e mëparshme e Sharit e katërta e në të majtë të Lidhjes së Prizrenit emërohet (**Gjirokastra** )  
(*marrëveshje me grupet e asamblastëve*)
63. Rruga e pestë në të majtë të L. së Prizrenit emërohet (**Agim Shala**). ) (*KPF*)
64. Rruga e mëparshme B. Vllahoviq nga barnatorja e Avdulla Desku që kthehet përtej depos Model emërtohet rruga (**Alush Smajli**).
- 65.\* Rruga në të majtë të Lidhjes së Prizrenit përtej Ali Vorrit emërohet (**Emin Desku**).
66. Rruga në të majtë të rrugës kah Ujëmiri për Gjurgjevik të Vogël emërtohet rruga (**Zeqir Regjë Isufi**).
67. Rruga në të djathtë të L. së Prizrenit kah Fabrikat e deri te trafo emërohet (**Martirët e Kralanit**)
68. Rruga prej urës së vjetër në dalje të Klinës e deri te ura e Haxhisë emërtohet rruga (**Haxhi Zeka**)
- 69.\* Rruga e parë në të majtë të H.Zekës emërohet (**Beteja e Çelisë**.)
- 70.\* Rruga e dytë në të majtë të H.Zekës emërohet (**Ilir Merturi**).
- 71.\* Rruga e tretë në të majtë të H.Zekës emërohet (**Tahir Berisha**).
- 72.\* Rruga e katërtë në të majtë të H.Zekës emërohet (**Deshmorët e BL.Grabanicës**)
- 73.\* Rruga e pestë në të majtë të H.Zekës emërohet (**Sheshet Hasanaj**).
- 74.\* Rruga e parë në të djathtë të H.Zekës emërohet (**Martirët e Potërqit**).
75. Rruga nga ura e Haxhisë e deri te asfalti në lagjen Arbëria emërtohet rruga (**Shaban Palluzha**), *Gjeqovi në shkollën e Zllakuqanit, (marrëveshje me grupet e asamblastëve e KPF)*
76. Rruga nga (Shaban Polluzha) kah Marlekët emërtohet rruga ( **Mbretërit Teuta e Agroni**)
77. Rruga e parë në të majtë përtej ure në dalje të Klinës emërtohet rruga (**Sylë Plushi**), *kërkesë e familjes Palushi*.
78. Rruga e dytë në të majtë përtej urës së Klinës u emërtua (**Gazmend Zajmi**).
79. Rruga prej Zef Prenajt e deri te Abaz Duraku emërtohet rruga (**Maliq Gjema**), *Fehmiu në shkollën e mesme. Marrëveshje për mos-dyfishim emrash*
80. Rruga e asfaltuar për Dersnik emërtohet (**Malë Bashota**).
81. Rruga e re ne te djathtë të Malë Bashotës përtej hekurudhe së Prizrenit emërtohet (**Regjë Maloku**)
82. Rruga e re ne te majtë të Malë Bashotës përtej hekurudhe së Prizrenit emërtohet (**Fatmir Hoti**)
83. Rruga e parë në të djathtë në lagjen Arbëria përtej stacionit të autobusëve emërtohet rruga (**Ukë e Shaban Sadiku**).
84. Rruga e dytë në të djathtë në lagjen Arbëria emërtohet rruga (**Ali Berisha**), *Hoxhë Kadriu në rrugën te ambulanca (marrëveshje me grupet e asamblastëve dhe KPF)*.
85. Rruga e tretë në të djathtë në lagjen Arbëria emërtohet rruga (**Regjë Bajraktari**).
86. Rruga e katërt në të djathtë në lagjen Arbëria emërtohet rruga (**Kuvendi i Dobërdolit**).

87. Rruga në drejtim të shtëpisë së Dodë Ndrecajt emërtohet rruga (**Migjeni**).
88. Rruga nga Sadik Rama për në Dollc emërohet (**Prek Zef Ademi**) KPF
89. Rruga nga Sadik Rama te Selimët emërtohet rruga e (**UÇK**)
- 90.\* Rruga e parë në të djathtë afër Golatesë (**Dëshmorët e Rudices**) *plots.i asamblesë.*
- 91.\* Rruga e dytë te Golatea emërohet (**Martirët e Qabiqit**).
92. Rruga e mëparshme 7 Korriku te stacioni i trenit në të majtë të rrugës A. Smajlit emërtohet (**Mulla Ilaz Broja**) *Faruk Elezi në shesh (marrëveshje me grupet e asamblistëve).*
93. Rruga e parë në të majtë të rrugës Mulla Ilaz Broja emërtohet rruga (**Jakup Agushi**).
94. Rruga e Dytë në të majtë të Mulla Ilaz Brojës emërohet (**Martirët e Izbicës**).
95. \* Rruga e parë në të djathtë të Mulla Ilaz Brojës te kthesa emërohet- (**Dëshmorët e Shushmanit**)
96. \* Rruga e dytë në të djathtë të Mulla Ilaz Brojës kah Hamdi Perqeva Emërohet (**Halim Ngucati**)
97. Rruga nga I. Boletini deri te lumi Klina emërtohet rruga (**Ramadan Shabani**).
98. Rruga në të majtë te hyrja në oborrin e gjimnazit emërtohet rruga (**Ilaz Gashi**).

### 3. Kemi 98 rrugë

*PS. Rrugët e shënuara me \* tregojnë se kemi te bëjmë me rrugë të reja të emërtuara.*

#### VEREJTJE:

Janë plotësuar kërkesat e asamblistëve. Po ashtu janë hequr emërtimet e dyfishuara në sheshe shkolla e rrugë sipas marrëveshjes.

Janë plotësuar edhe gjithë emrat e propozuar për riemërtim nga përfaqësuesit e parive politike dhe KPF.

Nga Komiteti për Politik dhe Financa dhe Shoqatat e dala nga Lufta komisionit i kanë ardhur kërkesat që pallati i Sporteve të marrë emrin e Skënder Mërturit, kjo gjë është prezantuar, por komisioni me përfaqësuesit e Partive politike ka punuar vetëm në emërtimin e rrugëve dhe sheshe.

Rrugë e reja të pa emërtuara dhe sa zëvendësime kanë plotësuar propozimet e asamblistëve të cilët kanë miratuar propozimin me plotësime të propozimeve të tyre të cilat i mbetën Komisionit për plotësime.

KOMISIONI KOMUNAL  
për standardizimin e emërtimeve  
KRYETARI  
Prof. Dr. Asllan KRASNIQI

